

VENDIM
Nr.35, datë 1.2.2011

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.33, DATË 15.2.2010 “PËR SKEMËN EKZISTUESE
TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------|---------|
| - Nasip Naço | kryetar |
| - Mimoza Dhëmbi | anëtare |
| - Besjan Pesha | anëtar |
| - Arben Ndoci | anëtar |
| - Zef Preçi | anëtar, |

në mbledhjen e tij të datës 1.2.2011, shqyrtoi vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.33, datë 15.2.2010 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave” dhe argumentet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit për Transportin në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit me shkresë nr.4828/1, datë 21.12.2010, lidhur me përgatitjen e planit të ristrukturimit të sektorit hekurudhor,

VËREN SE:

Subvencionimi nga Buxheti i Shtetit i “Hekurudha Shqiptare” sh.a., lidhur me shërbimin e transportit të udhëtarëve, në bazë të nenit 4 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmë shtetërore”, të ndryshuar, nuk përbën ndihmë shtetërore për arsye se ndërmarrja (“Hekurudha Shqiptare” sh.a.), është operator i vetëm në treg dhe operon vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si rrjedhim nuk ndikon ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën dhe nuk ka asnjë efekt në tregun e brendshëm të transportit hekurudhor dhe atë ndërmjet shteteve.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), me shkresë nr.4828/1, datë 21.12.2010, paraqiti të gjitha argumentet e grupit të punës për hartimin e planit të ristrukturimit dhe konsulentëve të huaj, lidhur me gjendjen dhe problematikën e sektorit hekurudhor. Sipas MPPT-së me nivelin aktual të investimeve për “Hekurudha Shqiptare” sh.a., nuk mund të ketë përmirësim të gjendjes së infrastrukturës dhe të superstrukturës hekurudhore dhe për këtë arsye nuk do të mund “të përgatitet një plan ristrukturimi, ku të përcaktohen masat që do t'i kthejnë rentabilitetin këtij sektori, së bashku me afatet përkatëse”, siç parashikohet në vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.33, datë 15.2.2010.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenet 4 pika 1, 17 shkronja “ç” dhe nenit 19 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në nenet 121 dhe 124 të ligjit nr.8485, datë 27.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Revokimin e vendimit nr.33, datë 15.2.2010 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço